

Titulli i lëndës: Kimia e ambientit

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Ndërtimtarisë
Titulli i lëndës:	Kimia e ambientit
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve/Semestri:	I (semestri i II-të)
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E enjte
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Ismet Hashani
Detajet kontaktuese:	Tel: 044964670
Përshkrimi i lëndës	Lënda e kimisë së mjedisit është e nevojshëm për studentët e inxhinierisë mjedisore, sepse siguron bazat e nevojshme në kiminë mjedisore për të ndjekur një karrierë në inxhinierinë mjedisore. Ky është një kurs bazik i nivelit universitar për kimi mjedisore, i cili përfshinë hyrje në kiminë e mjedisit, kimia e atmosferës dhe ndotja e ajrit, kimia e hidrosferës, kimia e ujit dhe ndotja e ujit, kimia e biosferës, ndryshimet klimatike dhe energjia, ndotësit tipik dhe fati i tyre në mjedis, komponimet organike toksike dhe metalet, kimia e truallit, toka, sedimentet, dhe mbeturinat
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kursit të kimisë së mjedisit është që të përgatisë studentët për të vijuar studimet në lëndët e afërta me fushën e kimisë mjedisore të rëndësishme për inxhinierinë mjedisore të cilat do të mbahen në semestrat në vijim. Ky paraqet një kurs hyrës në kiminë e mjedisit për inxhinierët e mjedisit, që nënkupton se paraprakisht kemi njohuri bazike për këtë lëndë. Ligjëratat kanë për qëllim zhvillimin e njohurive bazë për parimet themelore të kimisë së mjedisit që ndikojnë në proceset mjedisore të tilla si ujë dhe trajtimin e ujërave hedhurinë, kontrollin e ndotjes së ajrit dhe menaxhimin e mbeturinave.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundimin të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë bazat e kimisë së mjedisit; • Kuptojnë kiminë e tokës, ajrit dhe ujit; • Kuptojnë mekanizmin me të cilin ndotësit mund të ndikojnë në cilësinë e tokës, ajrit dhe ujit; • Kuptojnë lidhjet midis tokës, ajrit dhe ujit, si dhe lëvizjen e elementeve midis tyre; • Kuptojnë burimet kryesore të energjisë dhe ndikimeve mjedisore të secilit prej tyre.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e tënxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithësej
Ligjerata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Konsultime	1	15	15
Ushtrime në teren	0	0	0
Seminare	2	2	4
Detyra shtëpie	1	15	15
Koha individuale e shpenzuar për studime (në bibliotek apo në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja finale për provim	1	5	5
Koha e shpenzuar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projekte, prezantime, etj.	2	2	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënjes është e bazuar në: Ligjerata, ushtrime, seminare dhe debate, konsultime, detyra të pavarura, detyra shtëpie, kollokviume, provime.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 25%: Vlerësimi i dytë: 25%: Detyra shtëpie dhe seminare 10% Ardhja e rregullt: 5% Provimi final: 35% Totali : 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - A. Çullaj, Kimia e mjedisit, Tiranë, 2012. - Si literaturë e bazë e kursit do të jenë ligjëratat e autorizuara nga mësimdhënësi. 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Manahan, Environmental Chemistry, 5th Edition, 1991. - R. M. Harrison, An Introduction to Environmental Chemistry and Pollution, London, 1994. - O. Nill, Environmental Chemistry, See. Ed. London, 1993. 		

Plani i dizajnuar i mësimit - Ligjerata

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në kiminë e mjedisit
Java e dytë:	Kimia e atmosferës dhe ndotja e ajrit
Java e tretë:	Kimia e hidrosferës
Java e katërt:	Kimia e ujit dhe ndotja e ujit
Java e pestë:	Monitrimi dhe analiza kimike e ujërave
Java e gjashtë:	Kimia e biosferës,
Java e shtatë:	Ndryshimet klimatike dhe energjia,
Java e tetë:	Ndotësit tipik dhe fati i tyre në mjedis,
Java e nëntë:	Komponimet organike toksike dhe metalet,
Java e dhjetë:	Kimia e truallit,
Java e njëmbëdhjetë:	Toka dhe sedimentet
Java e dymbëdhjetë:	Mbeturinat
Java e trembëdhjetë:	Menaxhimi i mbeturinave
Java e katërbëdhjetë:	Kimia e mjedisit e mbeturinave të rrezikshme
Java pesëmbëdhjetë:	Efektet shëndetësore të ndotjeve kimike

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.